



Afërsisht gjysma e energjisë së përdorur në banesa shkon për ngrohje. Futja e ngrohjes në bazë të biomasës ju ndihmon të bëni përmirësime të kursimit të energjisë në shtëpinë tuaj dhe të gjeni mënyrën më të mirë për të ulur koston e ngrohjes.


Nga perspektiva e konsumatorit final në Ballkanin Perëndimor, kursimet financiare të krijuara nga futja e ngrohjes në bazë të biomasës shpesh janë shumë të rëndësishme. Në shumicën e rasteve, zëvendësimi i një sistemi ekzistues të ngrohjes me një teknologji ngrohjeje të bazuar në biomasë mund të zvogëlojë shpenzimet në mënyrë domethënëse. Për shembull:

- Ngrohja me soba efikase druri kundrejt pajisjeve elektrike mund të gjenerojë kursime deri në 40-74%
- Ngrohja me soba druri moderne dhe efikase kundrejt sobave të drurit të vjetra dhe jo efikase mund të gjenerojë kursime deri në 51-53%
- Ngrohja me bojlerë të vegjël me ashkla kundrejt pajisjeve elektrike mund të gjenerojë kursime deri në 52-77%
- Ngrohja me bojlerë të vegjël me ashkla kundrejt naftës së lehtë/ LPG për bojlerë të vegjël mund të gjenerojë kursime deri në 49-70%
- Ngrohja me soba me peleta kundrejt pajisjeve elektrike mund të gjenerojë kursime deri në 12-51%
- Ngrohja me bojlerë të vegjël me peleta kundrejt pajisjeve elektrike mund të gjenerojë kursime deri në 22-59%

Ngrohja me biomasë mund të çojë në kursime të konsiderueshme vjetore, veçanërisht për përdoruesit që kanë kërkesa të larta të përdorimit të nxehtësisë. Kostoja e nxehtësisë së prodhuar nga ashklat e drurit ose drurët e zjarrit është dukshëm më e ulët se kostoja e ngrohjes së prodhuar nga nafta, gazi ose energjia elektrike.

A deliverable of Heat Wisely, public awareness raising project on biomass-based heating in the Western Balkans





Wood chips	Ashklat e drurit
Coal	Qymyri
Firewood	Drurët e Zjarrit
Natural gas	Gazi natyror
Wood pellets	Peletat e drurit
Fuel oil	Nafta
Electricity	Energjia elektrike

Përdorimi i biomasës për ngrohje redukton varësinë nga shpenzimet e luhatshme të ngrohjes që lidhen me lëndët djegëse fosile dhe mbështet ekonominë lokale.


Në varësi të llojit të shtëpive, opsionet më tërheqëse për ngrohjen me biomasë – që sigurojnë përfitimet më të mëdha për qytetarët e Ballkanit Perëndimor janë :

A deliverable of Heat Wisely, public awareness raising project on biomass-based heating in the Western Balkans



Në ndërtesa të pavarura	Zëvendësimi i sobave të drurëve jo efikase me soba efikase Kalimi nga pajisjet e ngrohjes elektrike në sobat efikase me biomasë
Në ndërtesa shumëkatëshe	Kalimi nga pajisjet ngrohëse elektrike në bojlerët me ashkla druri

Krahasimi i qëndrueshmërisë ekonomike, të opsioneve të ngrohjes me biomasë me karburantet fosile dhe opsionet e energjisë elektrike, është paraqitur në tabelë. Ana e majtë prezanton opsionet e ngrohjes në bazë të biomasës që janë krahasuar me opsionet e ngrohjes të listuara në rreshtin e parë, duke përdorur të njëjtin lloj pajisjeje për ngrohje.



A deliverable of Heat Wisely, public awareness raising project on biomass-based heating in the Western Balkans



Heating option	Opsioni i ngrohjes
Coal	Qymyri
Fuel oil	Nafta
Natural gas	Gazi natyror
Electricity	Energjia elektrike
Old firewood stove	Sobat e vjetra me dru
Small boiler – fuel: wood chips	Bojleri i vogël – lënda: ashkla
Small boiler – fuel: wood pellets	Bojleri i vogël – lënda: peletat e drurit
Efficient stove – fuel: firewood	Soba efikase- lënda: peleta druri
Efficient stove – fuel: wood pellet	Soba efikase – lënda : peleta druri
Legend	Legjendë
Biomass heating is cheaper	Ngrohja me biomasë është më e lirë
Biomass heating is more expensive	Ngrohja me biomasë është më e shtrenjtë

A deliverable of Heat Wisely, public awareness raising project on biomass-based heating in the Western Balkans

